

KPT-ja shkurtimisht




**Komiteti Evropian
për Parandalimin e Torturës
dhe të Trajtimit ose Dënimit
Çnjerëzor dhe Poshtëruës (KPT)**

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



Parandalimi i keqtrajtimit të personave që u është mohuar liria në Evropë

■ KPT-ja organizon vizita në vendet e ndalimit për të vlerësuar trajtimin e personave të cilëve u është mohuar liria. Këto vende përfshijnë burgjet, vendet e ndalimit për të rinjtë, rajonet e policisë, qendrat e ndalimit për imigrantë, spitalet psikiatrike, shtëpitë e kujdesit social, etj.

■ Delegacionete KPT-së kanë akses të pakufizuar në vendet e ndalimit dhe gëzojnë të drejtën e lëvizjes brenda këtyre ambienteve pa kufizim. Ata intervistojnë privatisht personat të cilëve u është mohuar liria dhe komunikojnë lirshëm me çdokënd që mund të japë informacion.

■ Pas çdo vizite, KPT-ja i dërgon një raport të detajuar shtetit përkatës. Ky raport përfshin informacionin e mbledhur nga KPT-ja si dhe rekomandimet, komentet dhe kërkesat e saj për informacion. KPT-ja kërkon dhe një përgjigje të detajuar për çështjet që ngrihen në raport. Raportet dhe përgjigjet janë pjesë e dialogut të vazhdueshëm me shtetet përkatëse.

■ Emri i plotë i KPT-së është “Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues”. Këtu theksohen dy tipare të rëndësishme: së pari, është organ evropian, dhe së dyti, mbulon jo vetëm “torturën”, por dhe një gamë të gjerë situatash të cilat mund të çojnë në “trajtim ose dënim çnjerëzor ose degradues”.

Vizitat

■ Vizitat kryhen nga delegacionet, të cilat zakonisht përbëhen nga disa anëtarë të KPT-së, të shoqëruar nga anëtarë të stafit të Sekretariatit të Komitetit dhe, nëse është e nevojshme, edhe nga ekspertë si dhe nga përkthyes.

■ Delegacionet e KPT-së kryejnë vizita në mënyrë periodike (në përgjithësi një herë në katër vjet), por kur është e nevojshme organizohen edhe vizita shpeshë "ad hoc".

■ Komiteti duhet të njoftojë shtetin përkatës që ka në plan të kryejë një vizitë. Pas këtij njoftimi, delegacioni i KPT-së mund të shkojë në çdo vend ku qëndrojnë personat të cilëve u është mohuar liria, në çdo kohë dhe pa njoftuar.

Bashkëpunimi dhe konfidencialiteti

■ Parimet e bashkëpunimit dhe konfidencialitetit mishërohen në Konventën ndërkombëtare mbi bazen e së cilës është krijuar KPT-ja.

- ▶ Bashkëpunimi me autoritetet kombëtare është në qëndër të punës së KPT-së, pasi qëllimi është mbrojtja e personave të cilëve u është mohuar liria dhe jo dënimi i shteteve për abuzimet.
- ▶ Konfidencialiteti është një tjetër karakteristike e punës së KPT-së: informacioni i mbledhur nga Komiteti, raportet e tij dhe përgjigjet e qeverive janë në parim konfidenciale. Pavarësisht nga kjo, një pjesë e mirë e informacionit rreth punës së KPT-së është në sferën publike.

Botimet

- ▶ Vetë shteti mund të kërkojë botimin e raportit të KPT-së, së bashku me përgjigjen e tij. Deri tani, pjesa më e madhe e shteteve kanë kërkuar t'i botojnë këto dokumente.
- ▶ Nëse një shtet nuk bashkëpunon ose refuzon të përmirësojë situatën në përputhje me rekomandimet e KPT-së, Komiteti mund të vendosë të bëjë një deklaratë publike.
- ▶ KPT-ja përpilon gjithashtu raportin e përgjithshëm mbi aktivitetet e saj, i cili botohet një herë në vit.

Struktura e KPT-së

- ▶ Anëtarët e KPT-së janë ekspertë të pavarur dhe të paanshëm dhe vijnë nga përvoja të ndryshme ku përfshihen juristë, mjekë si dhe specialistë në fushën e burgjeve ose të policisë.
- ▶ Për çdo shtet palë zgjidhet një anëtar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës. Anëtarët veprojnë në kapacitetin e tyre individual (d.m.th. ata nuk përfaqësojnë shtetin nga i cili janë zgjedhur). Për të garantuar më tej pavarësinë e tyre, anëtarët nuk vizitojnë Shtetin nga i cili janë zgjedhur.
- ▶ Sekretariati i KPT-ës është pjesë e Këshillit të Evropës.

Historiku

- ▶ KPT-ja është krijuar në bazë të “Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues” të Këshillit të Evropës, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1989.
- ▶ Ajo bazohet në Nenin 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e cila përcakton që “askush nuk duhet të jetë objekt torture ose trajtimi ose dënimi çnjerëzor ose degradues”.
- ▶ KPT-ja nuk është një organ hetimor, por ofron një mekanizem parandalues jo-gjyqësor për mbrojtjen e personave që u është mohuar liria nga tortura dhe forma të tjera të keqtrajtimit. Në këtë mënyrë, KPT-ja plotëson punën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ratifications

- ▶ Konventa është ratifikuar nga të 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.
- ▶ Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës mund të ftojë shtete jo anëtare të Organizatës për t’u bërë pjesë e Konventës.




Mund te lexoni:

- ▶ Raportet e vizitave të KPT-së, përgjigjet e qeverive, deklaratat publike dhe raportet e përgjithshme mund të gjenden në faqen e internetit të KPT-së.
- ▶ KPT-ja ka zhvilluar standarde në lidhje me trajtimin e personave të cilëve u është mohuar liria. Një përmbledhje e këtyre standardeve është botuar në broshurën “Standardet e KPT-së”.
- ▶ Një informacion më i detajuar në lidhje me mandatin e KPT-së dhe metodat e saj të punës mund të gjendet në tekstin e “Konventës Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues” dhe në “Raportin e tij Shpjegues”.

Mund të kontaktoni:

Secretariat of the CPT
Council of Europe
F-67075 Strasbourg Cedex
Francë

Internet: www.cpt.coe.int
E-mail: cptdoc@coe.int
Tel.: +33 (0)3 88 41 39 39
Fax: +33 (0)3 88 41 27 72



PREMS 106415

SQI

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, 28 prej të cilëve janë shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE